



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIVJAKË  
KËSHILLI BASHKIAK  
SEKRETARI

Nr 4980 / Prot

Divjakë më 19/10 /2022

**NJOFTIM**

**“Për perfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2022-2023”**

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 666, datë 10.10.2019, si dhe të shkresës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ardhur me nr 6478 prot më dt.07.10.2022” Mbi Planifikimin e Nr. të Bursave ju Njoftojmë se:

- a) Nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional në drejtimet mësimore: Bujqësi, Veterinari, Pyje, Ndërtim, Peshkim, Detari, Gjeologjo-miniera, dhe Shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës e gazit në Kërkesën e tyre për Bursa duhet të sigurojnë këto dokumenta:
1. Çertifikatë Familjare.
  2. Fotokopje e Kartës së Identitetit ( nëse ka mbush moshën) ose Çertifikatë personale me fotografi.
  3. Dëftesë e vitit( Kl.9-të) të fundit të Shkollës e noterizuar.
  4. Vërtetim që vazhdon studimet në vitin e parë akademik 2022-2023, nga Sekretaria e Shkollës së Mesme Profesionale.( Origjinale).
  5. Vërtetim nëse familja trajtohet me ndihmë ekonomike, njëri nga prindërit është invalid, nxënësi ka statusin e jetimit, kur prindi ka qenë punonjës policie dhe ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës,
  6. Vendim gjykate të formës së prerë për nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore.

**Nxënësit që të Përfitojnë bursë duhet të plotësojnë këto kritere:**

- b) Nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik.
- c) Nxënësit e arsimit profesional, të cilët kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notën mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë).
- d) Nxënësit të cilët kanë përfitur statusin e Jetimit.
- e) Nxënësit të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë.
- f) Nxënësit , të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik.
- g) Nxënësit të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë.
- h) Nxënësit , fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;
- i) Nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;
- j) Nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror.
- k) Nxënësit fëmijë të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Policisë së Burgjeve etj. të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
- l) Nxënësit (Vajza) të cilat ndjekin drejtimet mësimore: mekanike, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termohidraulikë;
- m) Nxënësit me një Prind.

Bashkangjitur dhe shkresa e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

**Të gjitha dokumentat të dorëzohen tek Sekretari i Këshillit të Bashkisë Divjakë.**

Nr.cel. 068 27 58 559.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Mimoza Thomaj